

Ndërkohë ankuesit kanë ngritur edhe një shqetësim tjetër që lidhet me këtë çështje. Ky shqetësim ka të bëjë me faktin se në mjaft raste drejtuesit e mjeteve megjithëse nuk kanë dijeni për gjobat administrative të vendosura në mungesë, ata ndalohen nga punonjësit e Policisë Rrugore dhe pengohen për të lëvizur me automjet brenda vendit ose të dalin lirisht me automjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa bërë më parë pagesën e detyrimeve përkatëse. Detyrimi për të likujduar pagesat e gjobave bëhet duke u tërhequr lejen e qarkullimit ose dërguar mjetin në parkime të dedikuara për Policinë e Shtetit.

Ndërsa disa ankues të tjerë kanë ngritur problemin se kanë bërë pagesat për gjobat e vendosura nëpërmjet bankave brenda afatit ligjor, por raportimi në sistemin elektronik e-gjoba është bërë me vonesë për shkak të procedurave bankare dhe ata përsëri kanë ngelur debitorë për kamat vonesën. Kurse në rastet kur pagesën e kanë bërë në zyrat e Postës Shqiptare, raportimi në sistem bëhet menjëherë sapo kryhet pagesa.

Përveç sa më sipër, është e rëndësishme që t'ju sjellim në vëmendje se problemi i vendosjes së gjobave në mungesë nga Policia e Shtetit në jo pak raste është bërë publik edhe nga media.

Për shqyrtimin e këtij problemi të ngritur nga ankuesit por edhe nga media, nga institucioni ynë u bënë inspektive në disa Organe Administrative Shetërore (OASH) pranë Drejtorive Vendore dhe në disa komisariate në shkallë vendi. Objekt i këtij inspektimi ishte respektimi i procedurave ligjore lidhur me gjobat e vendosura në mungesë nga punonjësit e Policisë së Shtetit (Policisë Rrugore dhe Policisë së Rendit), plotësimi i dokumentacionit lidhur me masat administrative në fushën e qarkullimit rrugor, funksionimi i OASH-eve, respektimi i të drejtave ligjore të shtetasve kundërvajtës nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, etj. Nga inspektimet dhe verifikimet e bëra rezultoi si më poshtë vijon:

1. Në veprimtarinë e përditshme në funksion të zbatimit të misionit ligjor për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, punonjësit e Policisë së Shtetit (Policisë Rrugore dhe Policisë së Rendit), vendosin gjoba ndaj drejtuesve të mjeteve të cilët kryejnë shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor. Aplikimi i gjobave administrative ka si qëllim vendosjen e rregullit dhe disiplinimit të drejtuesve të mjeteve me synim lëvizjen e lirë, të shpejtë dhe të sigurt në rrugë si për ata ashtu edhe për këmbësorët. Në disa raste, masat administrative nga punonjësit e Policisë së Shtetit vendosen në mungesë të drejtuesve të mjeteve. Kjo e drejtë është parashikuar në nenin 199¹ të Kodit Rrugor. Ndërkohë në këtë

¹ Neni 199 "Njoftimi i shkeljeve", parashikon se:

1. Kur nuk mund të përcaktohet menjëherë autori i shkeljes, procesverbali me të dhënat e sakta dhe të detajuara të shkeljes dhe me tregimin e motiveve që kanë bërë të pamundur përcaktimin e menjëhershëm, duhet, brenda 30 ditëve nga verifikimi i shkeljes, t'i njoftohet shkelësit përkatës ose, kur ky nuk është identifikuar dhe bëhet fjalë për shkelje të kryer nga drejtuesi i një mjeteve motor, i pajisur me targë njohjeje, njërit prej subjekteve të treguara në nenin 194, që rezulton nga regjistrat përkatës në datën e verifikimit. Kur bëhet fjalë për ciklomotorin njoftimi duhet t'i bëhet subjektit përgjegjës të qarkullimit sipas

dispozitë të Kodit Rrugor është parashikuar edhe detyrimi i organeve të policisë për të bërë njoftimin e shkeljes kundërvajtësit. Zakonisht kjo ndodh në qendrat e banuara në rastet e pushimeve dhe qëndrimeve të gabuara dhe drejtuesit e mjeteve të lëna në kundërvajtje (pronarët apo përdoruesit e tyre) nuk janë të pranishëm në vendin e konstatimit.

Në këto raste punonjësit e policisë përpilojnë procesverbalet e konstatimit të shkeljeve administrative dhe i vendosin në xhamin e automjeteve, poshtë fshirëseve.

Përveç sa më sipër, referuar Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022 *“Për procedurat e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”*, respektivisht Kreut VII, me titull *“Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor”*, pika 1, parashikohet se:

“Evidentimi në mungesë i kundërvajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor nga ana e shërbimeve të Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, bëhet në këto raste:

- a) pamundësia për të arritur një mjet, që lëviz me shpejtësi shumë të madhe;*
- b) kalim i një kryqëzimi me semafor, kur është ndezur drita e kuqe;*
- c) parakalim në kthesë;*
- d) zbulimi i një shkeljeje nga një funksionar, ose një agjent në bordin e një mjeti për transport publik, ose një mjeti tjetër të uniformuar, ose jo, kur është në pamundësi të ndjekjes së mjetit dhe të ndalimit të tij;*
- e) zbulimi i shkeljes me anë të mjeteve dhe pajisjeve automatike, elektronike, radarë të miratuar e certifikuar, që bëjnë të mundur përcaktimin e kundërvajtjes, vërtetimin e saj, në pamundësi të ndalimit të mjetit;*
- f) zbulimi i shkeljes në mungesë të shkelësit dhe të pronarit të mjetit”.*

Ndërsa në pikën 2 të këtij Kreu parashikohet se:

“Në rastet e konstatimit të shkeljeve të normave të qarkullimit në mungesë të drejtuesit të mjetit, punonjësi i policisë vepron si më poshtë:

nenit 96, pika 1, shkronja “b”. Kur shkelësi ose një tjetër nga subjektet e treguara identifikohet më vonë, njoftimi mund t’u bëhet atyre brenda 30 ditëve nga identifikimi.

2. Për banuesit jashtë vendit njoftimi duhet të kryhet brenda 360 ditëve nga verifikimi i shkeljes. Kur banimi ose vendbanimi i subjektit, të cilit duhet t’i bëhet njoftimi, nuk njihen, ky njoftim nuk është i detyrueshëm t’i bëhet këtij subjekti dhe i bëhet subjekteve të tjera sipas pikës 1.

3. Njoftimi bëhet nëpërmjet organeve të treguara në nenin 12, ose nga korrierët komunalë, me mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, apo nëpërmjet postës, sipas normave për njoftimet nëpërmjet shërbimit postar. Sidoqoftë njoftimet quhen të kryera me korrektësi kur bëhen në rezidencën ose vendbanimin e subjektit, që rezulton nga lejeqarkullimi ose nga arkivi kombëtar i mjeteve apo nga lejedrejtimi i drejtuesit të mjetit. Njoftimi i shkeljeve dhe i vendimeve, që merren nga organet e përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi, u dërgohet kundërvajtësve edhe me njoftim elektronik të certifikuar.

4. Shpenzimet e verifikimit dhe të njoftimit i ngarkohen personit që është i detyruar të paguajë gjobën administrative.

5. Subjekti, njoftimi i të cilit nuk kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar, nuk është më i detyruar të paguajë gjobën administrative.

a) Njofton menjëherë sallën e komandimit sipas juridiksionit territorial, duke i raportuar këto të dhëna: tipin, targën e mjetit, vendndodhjen, shkeljen e konstatuar, duke specifikuar sinjalistikën rrugore ekzistuese, numrin e serisë së procesverbalit të konstatimit që do të plotësojë;

b) plotëson procesverbalin e konstatimit dhe një kopje e vendos në xhamin e mjetit.

3. Punonjësi i shërbimit të sallës së komandimit të juridiksionit në rastet kur merr njoftim për konstatimet e shkeljeve të normave të qarkullimit rrugor në mungesë, vepron si më poshtë:

a) Plotëson menjëherë të dhënat e marra në regjistrin model 16 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Regjistri plotësohet në mënyrë kronologjike për çdo rast të raportuar. Mosplotësimi në kohë dhe saktë i regjistrit përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës fillon hetimi disiplinor në bazë të Rregullores së Policisë së Shtetit.

b) njofton eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë që njofton shkeljen e konstatuar;

c) kur një shkelje konstatohet nga një funksionar ose një agjent në bordin e një mjeti për transport publik, ose një mjeti tjetër të uniformuar, ose jo, kur është në pamundësi të ndjekjes së mjetit dhe të ndalimit të tij përpilon një raport shërbimi ku përshkruhet në mënyrë të hollësishme shkelja e konstatuar, vendi koha rrethana e pamundësisë për të mbajtur në prani të shkelësve procesverbalin e konstatimit të shkeljeve. Raporti i shërbimit i bashkëlidhet procesverbalit të konstatimit të shkeljes dhe administrohet bashkë me të.

4. Përcaktimi dhe verbalizimi i shkeljeve administrative nga mjetet automatike dhe elektronike bëhet nga operatorët e caktuar që administrojnë të dhënat”.

Sikurse rezulton nga dispozitat e cituara më sipër, në rastet e konstatimit të shkeljeve të normave të qarkullimit në mungesë të drejtuesit të mjetit, këta të fundit nuk e firmosin procesverbalin. Disa prej tyre mund të marrin dijeni duke gjetur procesverbalin e konstatimit të shkeljes në xhamin e mjetit, disa të tjerë ndoshta nuk marrin dijeni për kundërvajtjen e kryer sepse procesverbali i vendosur në xhamin e mjetit mund të mos gjendet se ku ka qenë vendosur nga faktorë atmosferikë (shiu, era), mund të jetë marrë nga fëmijë kalimtarë, etj. Pavarësisht këtyre rrethanave dhe shkaqeve, përderisa drejtuesit e mjeteve nuk kanë qenë prezent në momentin e konstatimit të shkeljes dhe nuk i kanë nënshkruar apo nuk kanë refuzuar nënshkrimin e procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve, këto raste konsiderohen gjopa të vendosura në mungesë të drejtuesit të mjetit.

Sqarojmë se nga informacioni i marrë në strukturat vendore të Policisë së Shtetit rezulton se numri i gjobave në mungesë të drejtuesve të mjeteve është i konsiderueshëm dhe konkretisht:

Në DVP Fier në muajin Korrik 2023 nga Policia Rrugore dhe ajo e Rendit Publik janë vendosur 12,085 gjoba gjithsej, nga të cilat 4,390 gjoba ose **rreth 36 % e tyre janë vendosur në mungesë**.

Në DVP Durrës, në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 5,014 gjoba gjithsej, nga të cilat 2,286 gjoba ose **rreth 46 % e tyre janë vendosur në mungesë**.

Në Komisarlatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë gjatë muajit Gusht 2023 vetëm nga punonjësit e këtij organi janë vendosur 28,406 gjoba gjithsej, nga të cilat 20,084 gjoba ose **rreth 71 % e tyre janë vendosur në mungesë të drejtuesve të mjeteve**.

Në DVP Shkodër në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 4,275 gjoba gjithsej, nga të cilat 2,461 gjoba ose **rreth 58 % e tyre janë vendosur në mungesë**.

Në DVP Vlorë në muajin Shtator 2023 nga Policia Rrugore janë vendosur 6,536 gjoba gjithsej, nga të cilat 4,929 gjoba ose **rreth 75 % e tyre janë vendosur në mungesë**.

Pra, sikurse rezulton nga shifrat e cituara më sipër, numri i gjobave të vendosura në mungesë nga punonjësit e Policisë Rrugore dhe ata të Rendit Publik është i konsiderueshëm dhe më i madh se sa numri i gjobave të vendosura në prezencë të drejtuesve të mjeteve.

2. Nga verifikimet e bërë lidhur me zbatimin e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 199 të Kodit Rrugor dhe Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022, për njoftimin brenda 30 ditëve të shkeljeve drejtuesve të mjeteve për rastet e evidentimit dhe konstatimit të tyre në mungesë, konstatoam se ky detyrim nuk respektohej në mënyrë korrekte konform ligjit.

Praktikisht, njoftimi i kundërvajtësve për gjobat e vendosura në mungesë bëhej formalisht me shkresë nga organi konstatoes duke ia dërguar organeve të Policisë së Shtetit ku ishin banorë kundërvajtësit me qëllim për të bërë njoftimin e tyre me punonjësit e policisë të zonave përkatëse, si dhe në sistemin elektronik e-gjoba kur ai funksiononte.

Nga verifikimet e bëra lidhur me faktin e njoftimit të kundërvajtësve brenda afatit ligjor prej 30 ditësh rezultoi se në pjesën më të madhe të njoftimeve të bëra, rreth 90 %, nuk ishin kthyer përgjigje strukturës njoftuese. Ndërsa pjesa tjetër e përgjigjeve të kthyera rreth 10 % informonin strukturën njoftuese se nuk ishin gjetur kundërvajtësit, për shkak se ata kishin ndryshuar vendbanimin, ishin larguar jashtë vendit, etj. Sipas punonjësve të policisë, kjo mënyrë njoftimi konsiderohej e mirëqënë dhe e realizuar rregullisht.

Theksojmë se vetëm dy raste nga DVP Shkodër dhe një rast nga DVP Vlorë u konstatua e provua që njoftimi të ishte kryer në mënyrë korrekte duke u konfirmuar marrja dijani nga vetë kundërvajtësi. Sjellim në vëmendje se Kodi Rrugor ka përcaktuar jo vetëm detyrimin e organit të policisë për njoftimin e kundërvajtësit në të tilla raste, por në të njëjtën kohë ka parashikuar edhe mënyrën e njoftimit, si *nëpërmjet organeve të treguara në nenin 12, ose nga korrierët, me mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës*

Civile, apo nëpërmjet postës, sipas normave për njoftimet nëpërmjet shërbimit postar. Gjithashtu Kodi Rrugor ka parashikuar edhe subjektin ndaj të cilit do të ngarkohen shpenzimet e verifikimit dhe të njoftimit në këto raste, i cili është kundërvajtësi.

Nga komunikimi me disa drejtues dhe punonjës të Policisë së Shtetit konstatoam se në fakt kjo dispozitë njihet prej tyre, por moszbatimi i saj justifikohet me: mungesën e infrastrukturës së nevojshme, si të regjistrimit të adresave, ndryshimin e adresave të drejtuesve të mjeteve dhe mos raportimin e këtij ndryshimi në organet përkatëse; mos parashikimi në organikën e strukturave të policisë rrugore dhe ato të rendit të punonjësve që duhet të kryejnë këtë punë, e cila është e konsiderueshme sidomos në Tiranë; mungesa e fondeve në buxhetet e tyre për shpenzimet postare, etj.

Theksojmë se në Komisaratin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, në organikën e vitit 2023 ishte ulur numri i punonjësve të policisë në krahasim me numrin e parashikuar në organikën e vitit 2015, me 50 efektivë më pak. Ndërkohë që Bashkia Tiranë ka një trend rritës në vijimësi sa i përket numrit të banorëve dhe po ashtu edhe të numrit të mjeteve. Gjithashtu në rritje është edhe numri i qytetarëve që me mjetet e tyre hyjnë dhe dalin në këtë qytet për të marrë shërbime apo për problematika të ndryshme nga banorë të qyteteve të tjera. Në gjykimin tonë, një strukturë organike jo proporcionale, e për më tepër mungesat në të, sjellin si pasojë rritjen e ngarkesës në punë të punonjësve të policisë, uljen e efikasitetit të punës dhe të nivelit të sigurisë në rrugë.

Nga ana tjetër, ne vlerësojmë se mungesa e adresës së saktë të disa pronarëve të mjeteve kundërvajtës nuk legjitimon moskryerjen e detyrimit ligjor për të bërë njoftimin e tyre me mënyrat e përcaktuara në ligj. Krijimi i sistemit të adresave apo i regjistrimit të adresave është detyrim i strukturave shtetërore qëndrore e vendore. Për realizimin e njoftimit kërkohet organizimi i punës nga strukturat drejtuese të Policisë Rrugore dhe e strukturave të tjera të Policisë së Shtetit, si dhe një bashkëpunim më i mirë me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

3. Është me rëndësi të theksojmë se, në pikën 5 të nenit 199 të Kodit Rrugor është parashikuar edhe pasoja juridike për mosbërjen e njoftimit brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Sipas kësaj dispozite, ***subjekti (drejtuesi i mjetit që ka bërë shkeljen) njoftimi i të cilit nuk kryhet brenda periudhës kohore të përcaktuar (30 ditëve), nuk është më i detyruar të paguajë gjobën administrative.*** Por, praktikisht këto gjopa vilen në kundërshtim me ligjin, me mënyrat e parashtruara më sipër, sepse në sistem subjektet rezultojnë debitorë. Duke mbajtur në konsideratë burokracinë, shpenzimet fillestare për përpilimin dhe regjistrimin e padisë në gjykatën kompetente, shpenzimet avokatore, kohën e gjatë të procesit gjyqësor, etj., kundërvajtësit pranojnë të paguajnë gjobën, ndonëse dispozita e mësipërme i përjashton nga ky detyrim, dhe nuk zgjedhin rrugën gjyqësore për zgjidhjen e kësaj padrejtësie.

Lidhur me këtë shqetësim për mosnjoftimin e kundërvajtësve për gjobat në mungesë para disa kohësh është prononcuar publikisht edhe Ministri i Brendshëm z. Taulant

Balla. Ndër të tjera, ai ka deklaruar se, nisur nga shqetësimet e qytetarëve, nga strukturat e Policisë së Shetit do të bëhet njoftimi kundërvajtësve në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit e-albania. Ne çmojmë se kjo mënyrë njoftimi do ta ndryshonte dhe përmirësonte deri diku këtë problematikë, por në rrethanat në të cilat ndodhet vendi ynë, nuk duhet të jetë mundësi e vetme pasi jo të gjithë drejtuesit e mjeteve kanë akses në internet, dhe për këtë shkak ata nuk mund të përdorin sistemin elektronik e-albania. Kjo mënyrë njoftimi nuk mund ta zgjidhë në mënyrë përfundimtare atë. Sipas vlerësimit tonë, për zgjidhjen e këtij shqetësimi duhet të reagohet menjëherë për krijimin e sistemit të adresave të qytetarëve tanë, i cili do të sillte garanci si për qytetarët ashtu edhe për administratën publike. Referuar pikës 3 të nenit 199 të Kodit Rrugor, *njoftimi i shkeljeve dhe i vendimeve, që merren nga organet e përcaktuara në dispozitat e këtij Kodi, në rrugë elektronike të certifikuar, është suplementar dhe jo i vetëm*. Pra, pavarësisht njoftimit elektronik, nuk duhet të hiqet dorë nga mënyrat e njoftimit të parashikuara në Kodin Rrugor, si nëpërmjet organeve të treguara në nenin 12, ose nga korrierët, me mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, apo nëpërmjet postës, sipas normave për njoftimet nëpërmjet shërbimit postar.

Vlen të sjellim në vëmendjen tuaj, se kemi konstatuar që gjambat e vendosura në mungesë të drejtuesve të mjeteve, nëse njoftimi i tyre nuk bëhej brenda afatit 30 ditor, nuk “fshiheshin” nga sistemi. Ato vazhdonin të qëndronin aktive dhe t’u vilesnin kundërvajtësve në kundërshtim me dispozitën ligjore. Ne vlerësojmë se për zgjidhjen e këtij shqetësimi duhet të bëhet ndërhyrje në sistemin e-gjyba me qëllim që ato të mos jenë më aktive automatikisht nëse njoftimi i kundërvajtësit nuk bëhet brenda 30 ditëve nga konstatimi i tyre.

Ndërsa gjambat e parashkruara pas kalimit të afatit dy vjet nga dhënia e tyre, sikurse parashikohet në nenin 204² të Kodit Rrugor dhe nenin 46³ të ligjit nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, “fshiheshin” (bëheshin jo aktive) në mënyrë automatike nga sistemi elektronik e-gjyba.

Sqarojmë se institucioni i Avokatit të Popullit nuk është kundër vendosjes së masave administrative ndaj drejtuesve të mjeteve që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor të parashikuara në dispozitat e Kodit Rrugor. Ndërkohë kërkojmë që ato të aplikohen me

² Neni 204 “Parashkrimi” parashikon se:

“Parashkrimi i së drejtës për vjeljen e shumave të detyruara nga masat administrative me gjobë, për shkeljet e parashikuara nga ky Kod, rregullohet me ligjin nr. 10 279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative””.

³ Neni 46 “Parashkrimi i dënimit administrativ”, parashikon se:

“Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet. Në këtë rast, organi administrativ, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative, me vendim konstaton parashkrimin. Në vendimin, ku konstatohet parashkrimi i dënimit administrativ, listohen edhe arsyet që kanë çuar në këtë përfundim.

objektivitet dhe duke respektuar të gjitha procedurat dhe afatet e njoftimit të parashikuara në aktet normative në fuqi dhe të mos kenë si qëllim “mbushjen e arkës së shtetit”. Gjithashtu vlerësojmë se duke vepruar kështu, aplikimi i këtyre masave do të ndikojë në edukimin dhe disiplinimin e drejtuesve të mjeteve, në parandalimin e aksidenteve automobilistike dhe të pasojave të rënda që ato shkaktojnë në humbjen e jetëve njerëzore, në dëmtimin e shëndetit të drejtuesve të mjeteve, të pasagjerëve, këmbësorëve dhe pasojave të tjera materiale të cilat janë evidente dhe të konsiderueshme në të tilla raste.

4. Lidhur me pagesën e gjobave konstatojmë se në rastet kur drejtuesit e mjeteve i paguanin ato me para në dorë (cash) në zyrat e Postës Shqiptare, raportimi i tyre bëhej menjëherë në sistemin e-gjopa dhe pas kësaj ato “fshiheshin” nga sistemi. Sipas informacionit të dhënë nga punonjësit e këtyre zyrave, të cilët ishin akomoduar pranë godinave të organeve të Policisë së Shtetit si p.sh. në DVP Durrës, në DVP Fier, në Komisariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë dhe DVP Vlorë, kjo mënyrë pagese dhe raportimi drejtpërdrejtë në sistemin e-gjopa ndodhte pasi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Postës Shqiptare ishte lidhur një marrëveshje bashkëpunimi.

Ndërkohë pagesa e gjobave bëhej edhe nëpërmjet Bankave të Nivelit të Dytë, me para në dorë (cash) apo on-line (nëpërmjet telefonit celular ose kompjuterit). Sqarojmë se kur pagesa bëhej on-line, veprimi i kryer shfaqej në aplikacionin e bankës ku kryhej veprimi. Ndërsa heqja e gjobës nga sistemi e-gjopa bëhej pas rakordimit të bankës me sektorin e financës së organit të policisë. Gjatë periudhës kohore nga kryerja e pagesës deri në datën e rakordimit, nëse kundërvajtësi do të ndalohej nga punonjësit e policisë, i tregonte atij mandat pagesën elektronike dhe nuk pengohej të qarkullonte me mjet. Sipas punonjësve të policisë, vonesa në rakordim ndodhte sepse deri më tani nuk është lidhur ndonjë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bankave të Nivelit të Dytë në lidhje me pagesat e gjobave dhe raportimin e tyre menjëherë në sistemin e-gjopa, sikurse është bërë me Postën Shqiptare. Ne çmojmë se vonesa e raportimit të pagesave të gjobave në sistem krijon premisa që kundërvajtësit të mos përfitojnë nga e drejta ligjore e parashikuar në nenin 203⁴ të Kodit Rrugor, për

⁴ Neni 203 “Vjelja e gjobave administrative” parashikon se:

1. Të ardhurat nga masat administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara nga nenet e këtij Kodi paguhen nga kundërvajtësi brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formën e prerë me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon gjobë në vend. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj. Kur gjoba nuk paguhet ose nuk nxirret dot nga të ardhurat e shkelësit, për rastet e drejtuesit të mjetit me motor, bëhet ndalimi i mjetit deri në tre muaj dhe pas këtij afati bëhet shitja e mjetit me ankand, duke i dhënë diferencën në lekë shkelësit.

2. Në të gjitha rastet e parashikuara me gjobë, nëse arkëtimi i vlerës së gjobës nga kundërvajtësi bëhet brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 50 për qind të vlerës.

3. Të ardhurat nga gjobat për shkeljet e parashikuara nga ky kod i kalojnë në masën 60 për qind organit që ka verifikuar shkeljen. Këto të ardhura do të përdoren për përmirësimin e shërbimit në zbatim të këtij

uljen e masës së gjobës deri në masën 50% dhe për mos pagimin e kamat vonesës, kur arkëtimet bëhen brenda 15 ditëve.

5. Lidhur me dokumentacionin e përpiluar nga agjentët verifikues⁵ gjatë konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, rezultoi se kur ata konstatojnë dhe verifikojnë shkelje të normave të legjislacionit rrugor, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, plotësojnë procesverbalin e konstatimit të shkeljes me gërma kapitale, në të gjitha rubrikat e tij, masën administrative me gjobë dhe atë plotësuese për normën e shkelur, duke respektuar kërkesat e neneve 193, 213 dhe 214, të Kodit Rrugor dhe informojnë kundërvajtësin mbi të drejtën e ankimit pranë Organit Administrativ Shtetëror.

Për evidentimin e shkeljes së kryer, mbahet procesverbali i konstatimit të shkeljes, sipas modelit të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor” (i ndryshuar) (lidhja nr. 1) dhe sipas formatit elektronik për gjobën elektronike (lidhja nr. 2 bashkëlidhur). Evidentimi i shkeljeve përveç procesverbalit të konstatimit të shkeljes në disa raste bëhet edhe duke i shoqëruar me raporte shërbimi, fotografi të bëra me pajisjet në përdorim, si tableta, radarë, makina inteligjente, si dhe testues alkooli. Megjithatë pajisjet në përdorim, me përjashtim të testuesit të alkoolit, ishin të pa mjaftueshme në raport me numrin e punonjësve të Policisë Rrugore.

Theksojmë se të dy tipet e procesverbaleve të konstatimit të shkeljes si ai manual (lidhja nr. 1) dhe ai elektronik (lidhja nr. 2) nuk kanë të pasqyruar të drejtën e kundërvajtësit për të bërë ankim ndaj masës së vendosur nga agjenti verifikues, organin ku mund të paraqitet ankimi, afatin dhe as mënyrën e përlllogaritjes së tij. Kjo mangësi vjen në kundërshtim me neni 99⁶ të Kodit të Procedurave Administrative, respektivisht pika 2, gërma “c”/iii.

Kodi, kurse 40 për qind i kalojnë shtetit. Kalimi i të ardhurave në buxhet bëhet sa herë që derdhen para në bankë, duke respektuar raportin e lartpërmendur.

⁵ Referuar Kreut I, pika 1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 155, datë 05.08.2022, kanë atributet e agjentit verifikues për konstatimin dhe evidentimin e shkeljeve në fushën e qarkullimit rrugor, punonjësit e policisë të shërbimit të Policisë Rrugore, si dhe të Patrullës së Përgjithshme të Policisë e SPZ-të, për sektorin e shërbimit/zonës policore që ata mbulojnë, në rastet e konstatimit të shkeljeve të parashikuara në nenet 155 dhe 156, të Kodit Rrugor.

⁶ Në nenin 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik” të K.Pr.A, parashikohet se:

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.
2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:
 - a) pjesën hyrëse, që përmban:
 - i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;
 - ii) palët të cilave u drejtohet akti;
 - iii) datën e miratimit;
 - iv) bazën ligjore;

Lidhur me afatin e ankimit në OASH ndaj masës administrative të marrë nga agjenti verifikues, Kodit Rrugor aktual nuk parashikon afatin e bërjes së tij. Kjo mangësi ka krijuar konfuzion si tek kundërvajtësit ashtu edhe në disa OASH. Për këtë arsye e vlerësojmë të nevojshme që të sqarohet këtë problematikë. Meqënëse në Kodin Rrugor ka një boshllëk, atëherë duhet t'i referohemi Kodit të Procedurave Administrative, respektivisht nenit 132, me titull "Afatet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ", pika 1, ku parashikohet se: "*Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ.*" Pra, referuar këtij Kodi, ***afati i bërjes së ankimit në OASH nga kundërvajtësi ndaj masës administrative të vendosur nga agjenti verifikues është 30 ditë nga data e njoftimit të tij.***

Kundërvajtjet, sipas Kodit Rrugor, të ndryshuar, shqyrtohen vetëm në bazë të ankesës së shtetasve kundërvajtës nga OASH në territorin e të cilit është efektiv agjenti verifikues, ku është konstatuar shkelja ose nga OASH ku ka adresën e banimit kundërvajtësi, organe të cilat marrin vendimin përkatës, referuar nenit 201 të Kodit Rrugor. OASH përbëhet nga tre anëtarë dhe funksionon në mënyrë permanente. Ankesat shqyrtohen pa praninë e ankuesit, ndërsa kur nga OASH vlerësohet se ka nevojë për prova shtesë, ato i kërkojnë strukturave të policisë që kanë konstatuar dhe evidentuar shkeljen si dhe kundërvajtësit duke e thirrur atë. Në përfundim të shqyrtimit OASH merr vendimin përkatës, duke e pranuar atë plotësisht, pjesërisht ose rrëzuar dhe lënë në fuqi masën administrative të vendosur nga agjenti verifikues. Nga verifikimet e bëra kemi konstatuar se, pranimi i ankimit të kundërvajtësit se masa administrative e vendosur atij është e padrejtë, ndodhte shumë rrallë. Ndërsa ulja e masës së gjobës dhe heqja e pikëve të lejës së drejtimit të vendosur nga agjenti verifikues ishte bërë në disa raste. Sjellim në vëmendje se gjatë gjykimit administrativ të këtyre rasteve, OASH duhet të udhëhiqet nga parimi i barrës së provës për të provuar ligjshmërinë e akteve administrative. Ky parim është sanksionuar në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se: "1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë,", si dhe në nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

b) pjesën arsyetuese;

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;

iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial.

4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të ankuesit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë".

Përveç sa më sipër, zbatimi me korrektesë e objektivitet i këtij parimi bëhet i domosdoshëm nisur edhe nga fakti, që, nga shqyrtimi i ankesave të ardhura nga drejtuesit e mjeteve në institucionin tonë, në disa raste ka pasur pretendime lidhur vërtetësinë e faktit të shkeljes së atribuar atyre nga agjentët verifikues. Kundërshtimet ndaj masave administrative kanë qenë kryesisht për kalimin në semafor me dritë të kuqe, përdorimin e telefonit celular ose për mos vendosjen e rripit të sigurimit në lëvizje. Për të eliminuar dyshimet e mundshme në lidhje me vërtetësinë e faktit të shkeljes, është e nevojshme që për të provuar shkeljen administrative, nga agjenti verifikues dhe OASH përveç procesverbalit të konstatimit të shkeljes të administrohen edhe prova të tjera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve/mjeteve teknike, sikurse parashikohet në nenin 80, gërma "b"⁷ të Kodit të Procedurave Administrative.

Sqarojmë se në Sektorin e Policisë Rrugore në DVP Vlorë konstatojmë se në rastet kur agjenti verifikues kryente testin e alkoolit ndaj drejtuesit të mjetit e dokumentonte veprimin e testimit nëpërmjet pamjeve me video-audio ku fiksohej personi që i nënshtrohej testit dhe rezultati i tij. Ky dokumentim dhe pamjet shpërndareshin në grupin e WhatsApp të këtij sektori, por ai bëhej me pajisjet personale (smartphone) të punonjësve të Policisë Rrugore.

Për sa më sipër, ne vlerësojmë se pajisja e punonjësve të Policisë Rrugore/agjentëve verifikues me mjete profesionale bashkëkohore për dokumentimin e plotë të shkeljeve administrative do ta zgjidhte këtë problematikë.

Vendimi i marrë nga OASH i njoftojë ankuesit me telefon, me shkresë, e-mail, sistemin e-gjykoje dhe kur ai ishte i pranishëm bëhej drejtpërdrejtë duke i dhënë kopjen e vendimit. Sipas informacionit të dhënë nga punonjësit e OASH, ndodhte që në sistemin e-gjykoje masat administrative, si pezullimi i lejes së drejtimit, heqja e saj dhe heqja e pikëve, nuk pasqyroheshin gjithmonë në këtë sistem.

Në vendimin e OASH pasqyrohej e drejta ankimit, organi dhe afati i bërjes së tij. Afati ligjor prej 5 ditësh i bërjes së ankimit në gjykatë, i parashikuar në nenin 202 të Kodit Rrugor, në vlerësimin tonë është i pa mjaftueshëm dhe jo i arsyeshëm, por kjo

⁷ Neni 80 "Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës" parashikon se:

"1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; ..."

problematikë do të jetë objekt i trajtimit nga ana jonë në një rekomandim tjetër që lidhet me përmirësimin e Kodit Rrugor.

6. Nisur nga numri i konsiderueshëm i aksidenteve rrugore, një nga qëllimet e inspektimeve të kryera nga institucioni ynë në strukturat e Policisë Rrugore ishte edhe monitorimi e vlerësimi i punës të këtij organi lidhur me kryerjen e fushatave ndërgjegjësuere të qytetarëve dhe sidomos nxënësve të shkollave me qëllim njohjen dhe respektimin e rregullave të Kodit Rrugor. Ne vlerësojmë se kryerja në vijimësi dhe me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit e këtij aktiviteti do të ndikojë dukshëm në edukimin dhe parandalimin e aksidenteve automobilistike dhe për rrjedhojë edhe të pasojave që ato sjellin.

Lidhur me këtë veprimtari konstatuam se nga punonjësit e OASH të inspektuara ishte bërë një punë e mirë dhe në mënyrë të programuar, duke organizuar takime me nxënësit e shkollave 9 vjeçare e të mesme. Ndërkohë duhet të theksojmë se veprimtaria ndërgjegjësuere e parandaluese e Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ishte e vlerësueshme dhe duhet të përgjithësohet edhe në strukturat e tjera. Nga ky komisarariat përveç sa më sipër ishin përgatitur edhe disa fletë palosje në të cilat ishin pasqyruar rregullat e qarkullimit rrugor që duhet të respektonin drejtuesit e mjeteve dhe këmbësorët. Ndërkohë në autostradën Tiranë-Durrës, në afërsi të “Casa Italia” ishte vendosur një monitor dhe drejtuesit e mjeteve që konstatoheshin në shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor ndaloheshin dhe nëpërmjet monitorit iu tregoheshin pasojat që vijnë nga shkeljet e rregullave. Pas kësaj, ata këshilloheshin dhe nuk ndëshkoheshin me qëllim për t’u dhënë mesazh se nuk kishin si qëllim ndëshkimin e tyre, por edukimin, zbatimin e rregullave, rritjen e sigurisë në rrugë dhe sigurimin e jetës e shëndetit.

Për sa më sipër dhe për zgjidhjen e këtij shqetësimi të drejtuesve të mjeteve, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, të nenin 21/b, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në të cilin parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, dhe në nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;”

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme organizative për zbatimin nga strukturat e Policisë së Shtetit, të detyrimit që rrjedh nga neni 199 i Kodit Rrugor lidhur me njoftimin e

shkeljeve kundërvajtësve në mungesë duke zbatuar mënyrat e njoftimit të parashikuara në Kodin Rrugor, si nëpërmjet policisë rrugore, korrierët komunalë, postës, si dhe në rrugë elektronike.

2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin e praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për vjeljen e gjobave të vendosura nga punonjësit e policisë në mungesë të drejtuesve të mjeteve, kur njoftimi i tyre nuk është bërë brenda afatit ligjor 30 ditor.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për revokimin e gjobave administrative të vendosura në bazë të dispozitave të Kodit Rrugor në mungesë të drejtuesve të mjeteve për të cilat nuk është bërë njoftimi konform ligjit dhe brenda afatit 30 ditor, si dhe “fshirjen” e tyre nga sistemi e-gjoha.

4. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e të gjithë punonjësve të Policisë Rrugore/agjentëve verifikues me mjete profesionale bashkëkohore për të bërë të mundur dokumentimin e plotë të shkeljeve administrative.

5. Marrjen e masave të nevojshme për lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me Bankat e Nivelit të Dytë me qëllim, për rakordimin e shpejtë në rrugë elektronike në sistemin e-gjoha ndërmjet policisë dhe bankave lidhur me pagimin/arkëtimin e gjobave nga drejtuesit e mjeteve.

6. Marrjen e masave të nevojshme teknike me qëllim që në sistemin e-gjoha të mundësohet evidentimi dhe pasqyrimi i plotë i vendimit të marrë nga OASH lidhur me masat administrative, si pezullimi e lejes së drejtimit, heqja e saj dhe heqja e pikëve.

7. Marrjen e masave të nevojshme për të ndryshuar e përmirësuar dy tipet e procesverbaleve të konstatimit të shkeljes, procesverbalin manual (lidhja nr. 1) dhe atë elektronik (lidhja nr. 2) duke vendosur/pasqyruar të drejtën e kundërvajtësit për të bërë ankim ndaj masës administrative të vendosur nga agjenti verifikues, organin ku mund të paraqitet ankimi, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij.

8. Marrjen e masave të nevojshme për ngritjen sa më shpejtë të sistemit të adresave të qytetarëve.

9. Marrjen e masave të nevojshme organizative për rishikimin e organikave të strukturave të Policisë së Shtetit dhe shtimin e punonjësve në Sektorin e Policisë Rrugore, veçanërisht në Komisariatin e Policisë Rrugore Tiranë për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të punës në fushën e qarkullimit rrugor dhe ndjekjen e procedurave ligjore për njoftimin e drejtuesve të mjeteve ndaj të cilëve janë vendosur gjoba në mungesë.

10. Marrjen e masave organizative nga strukturat qendrore e vendore të Policisë Rrugore për kryerjen periodike të fushatave ndërgjegjësuere të qytetarëve nëpërmjet TV kombëtare e rajonale, përgatitjes e shpërndarjes së fletë palosjeve dhe organizimit të takimeve e bisedave me nxënësit e shkollave të arsimit parauniversitar (9 vjeçar dhe të arsimit të mesëm) për njohjen dhe respektimin e rregullave të Kodit Rrugor.

Për qëndrimin që do të mbani lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve, sikurse parashikohet në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi